



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.291/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;03.02.2025, merr këtë,

#### VE N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.291/2025, e datës;01.02.2025, parashtruar kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

PZAP-i me datë;01.02.2025 ka pranuar ankesën Anr.291/2025 nga subjekti politik LVV me te cilën thekson se më 1 shkurt 2025, përkundër Vendimit të PZAP Anr.85/2025 të datës;24 janar 2025 përmes të cilit, vendosjen e postereve/banereve të kandidatëve për deputetë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës - LDK në hapësirat/rrugët publike të Prishtinës i ka vendosur dhe vlerësuar si në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë kanë identifikuar se më 1 shkurt 2025 banerët/posterët e vendosura në hapësirat e njëjta publike/rrugët publike të kandidatëve të shumtë të LDK-së për deputetë, vazhdojnë të jenë të jenë aktive të postuara në hapësirat publike. Parashtruesi i ankesës thekson se PZAP me Vendimin Anr.85/2025 të datës 24 janar 2025, kishte përfshirë dhe kishte trajtuar ankesat si në vijim:Anr.85/2025, Anr.86/2025,Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025 dhe Anr.118/2025, ndaj kandidatëve për deputetë nga radhët e LDK-së si: Lumir Abdixhiku, Izet sadiku, Fiknete Bejta, Shkëmb Manaj, Sokol Havolli, Doruntinë Maloku, Besian Mustafa, Doarsa Kica Xhelili, Arben Gashi, Alban Zogaj, Sibel Halimi dhe kandidatë të tjerë,

të cilët në hapësirat e ndryshme publike në rrugët si: "Rruga C", "Hemine Lekaj", "Afrim Zhitia", Xheladin Rekalii", "Enver Maloku", "Fehmi Lladrovci", "Arbnor e Astrit Dehari", "Eqrem Qabej" e të tjera (sic janë përfshirë në Vendimin Anr 85/2025 të PZAP) në Prishtinë, kishin vendosur posteret/baneret e tillë. Me këtë veprim, ndonëse të sanksionuara nga PZAP si veprime të subjektit LDK në kundërshtim me dispozitat e nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 12, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës — LZP, posterët/banesët e tillë vazhdojnë të jenë të vendosura në këto hapësira përkatëse publike, në kundërshtim me dispozitat e LZP-së. Si dëshmi ka bashkangjitur provën: Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP, si dhe Foto dhe Link i Vendimit të PZAP Anr.85/2025.

Më datë;31.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë;01.02.2025. Subjekti politik LDK brenda afatit të parapare ligjor ushtron përgjigje në ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Duke theksuar se pretendimi se subjekti politik LDK nuk ka respektuar Vendimin A.nr 85/2025, nuk qëndron sepse të njëjtin e kemi ankimuar në Gjykatë Supreme të Kosovës brenda afatit të parapare prej 48 orësh, në përputhje me nenin 118. 4 të LZP dhe kësioj Vendimi i PZAP nuk ka marr formë të prere, që nënkupton se ende nuk është i permbarueshem apo ekzekutueshem perderisa Gjykata Supreme të vendos sipas ankeses se bere nga subjekti LDK. Meqë tek me date 01.02.2025 në ora 16:00 subjekti LDK ka pranuar me poste Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, dhe kësioj brenda afatit (me pak se 24 ore) ka reaguar duke larguar të gjithë posteret nga të gjitha pritoret. Prove: Fotot e bashkëngjitura nga terreni. Pra, është hera e dyte apo e trete që subjekti LVV parashtrohet ankesë të njëjtë, duke abuzuar kësioj me të drejtën e ankesës, sepse është ditur saktësisht që ankesa në Supreme e shtynë ekzekutimin e Vendimit të PZAP, deri në marrjen e formes se prere të Vendimit të Gjykatës Supreme; dhe se kjo çështje tashme është res-judicata. Subjekti LDK ka respektuar kësioj verdiktin final të dal nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosoves AA.nr.19/2025, të nxjerr me date 01.02.2025 dhe ka filluar me largimin e të gjithë postereve të vendosur neper pritoret e Kryeqytetit. Duke marre parasysh ato që u ceken me larte kërkojmë nga PZAP që të marr vendim meritor per rastin në fjale dhe duke u bazuar në krejt ato që u thane kerkojme që ankesa e subjektit LVV të refuzohet si e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtuar nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara.

Kjo për faktin se parashtuesi i ankesës i referohet shkeljes së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe thekson se përkundër vendimit të PZAP-it e njëjta nuk i ka larguar posterat nga vendet ku kanë qene të vendosura, për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara për faktin se subjekti politik LDK, ka ofruar provat të cilat ia ka bashkangjitur përgjegjës në ankesë, ku vërtetohet fakti e njëjta i ka larguar posterat e vendosura nga pritoret/hapsirat publike ku kanë qenë të vendosura. Me ç'rast ka zbatuar vendimet e PZAP-së të formës së prerë.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e

tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.291/2025, datë;03.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.